



# Shteti i së drejtës

Shteti i së drejtës është bazamenti i drejtësisë, demokracisë dhe zhvillimit. Është e pamundshme që një shoqëri dhe shtet të jetë i drejtë dhe të zhvillohet po që se nuk ndërtohet mbi parimin e sundimit të ligjit dhe barazisë së qytetarëve para ligjit. Shteti është i së drejtës atëherë kur principi organizativ i tij është kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, kurse ligjet janë në përputhje me interesin qytetar dhe kombëtar.

Shteti i së drejtës është shtet i transparencës. Gjithçka funksionon dhe organizohet sipas rregullave të cilat artikulojnë dhe mbrojnë interesin e njerëzve, prandaj qytetari ndjehet i sigurt karshi ndërhyrjes arbitrare të pushtetit. Në anën tjetër, meqë vetë pushteti udhëhiqet nga ligjet dhe u bindet atyre, institucionet politike i nënshtrohen një sistemi të ndërvarësisë dhe kontrollit. Ato duhet të jenë të përgjegjshme dhe të japin llogari para popullit, aty ku ato e marrin legjitimitetin e ushtrimit të autoritetit të tyre politik.


Ne mendojmë që parimi i ndarjes së pushteteve e garanton pavarësinë e tyre dhe funksionimin adekuat të demokracisë. Aty ku pushteti politik ekzekutiv ndërhyt në punët e drejtësisë, nuk ka demokraci dhe drejtësi. Aty ku qeveria nuk i zbaton ligjet e miratuara të legjislativit, nuk ka shtet të së drejtës.

Republika e Kosovës vuan nga mungesa serioze e shtetit të së drejtës. Ne nuk duam vetëm që Kosova të jetë shtet, por që ky shtet të jetë i së drejtës. Në Kosovë njerëzit e pushtetit shpeshherë qëndrojnë mbi ligjin, kurse Qeveria jo rrallë herë i fut duart në punët e drejtësisë.

Për shkak të ndikimit të vazhdueshëm të pushtetit qeveritar mbi drejtësinë, sot kemi një gjyqësor më të dobët se kurrë. Gjyqtarët thirren me telefona dhe marrin kërcënime e porosi se si ta kryejnë punën e tyre. Cilën lëndë duhet të shtyjnë përpara e cilën ta shmangin. Kështu që, në vend që t'i shërbejë vënies së drejtësisë në vend, gjyqësori sot po funksionon shumë më tepër si instrument politik në duart e pushtetit politik.

Prokuroria e Republikës së Kosovës është krejtësisht pa mbrojtje dhe vazhdimisht e shantazhuar. Për këtë arsye kryeprokurori i Kosovës ka mbetur një figurë anonime, të cilën pakkush nga qytetarët e Kosovës e njeh. Ka aq shumë punë që e pret prokurorinë në Kosovë, kurse aq pak rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është vendosmërisht e përcaktuar për ta kthyer Kosovën në shtet të së drejtës. Në programin tonë politik shteti i së drejtës merr rol qendror sepse ai është i pakompensueshëm për demokracinë dhe zhvillimin që aq shumë i duhet vendit tonë. Në mungesë të shtetit të së drejtës, i cili duhet të jetë në fundament të organizimit politik, çdo investim tjetër është i kotë dhe shkon huq. Prandaj shteti i së drejtës duhet të jetë pikënisja e të gjitha arritjeve tjera të ardhshme, duke filluar nga drejtësia, e deri te ekonomia.



# 1. Republika, sovrانيتeti, qeverisja

## Republika

Për Lëvizjen VETËVENDOSJE! **shteti është Republika**. Shteti është subjekt sovran: i vetëdijshëm politikisht, unik territorialisht, integral institucionalisht. Shteti pajtohet që veprimet e tij të jenë në përputhje me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ato civile, politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe ato të pakicave.

Republika është parlamentarizëm i fuqishëm, demokraci e qëndrueshme, ndarje e pushteteve dhe drejtësi e pavarur. Fryma e republikës është kushtetuta, e materializim i saj janë ligjet. Parimi themelor i republikës është barazia, e hapësira e saj është publikja. Thelbi i ligjeve është pronësia publike e qytetarëve mbi to. **Kosova duhet të jetë republikë parlamentare**. Qeveria është përgjegjëse para Kuvendit. Ajo është llogaridhënëse ndaj popullit.

Kushtetuta aktuale ia mohon Kosovës vetëvendosjen e brendshme përmes misionëve të huaja sunduese që kanë fuqi ekzekutive dhe imunitet prej ligjit, kurse vetëvendosjen e jashtme përmes Nenit 1.3 që ia mohon asaj të drejtën e bashkimit me një shtet tjetër.

## Kushtetuta

Kosova ka nevojë për një **kushtetutë të re** e cila do të përgatitet pas diskutimeve të gjera që përfshijnë në përgjithësi qytetarët e në veçanti profesionistët. Ajo do të miratohet me Referendum, me shumicë të cilësuar. Rendi kushtetues do të **eliminohet strukturën e pesëfishtë kontradiktore** të imponuar gjër më sot në Kosovë, të përbërë nga: Plani i Ahtisaarit, Ligjet e Republikës së Kosovës, rregulloret e UNMIK, ligjet e Serbisë dhe ligjet jodiskriminuese të ish-Jugosllavisë.

## Shteti për Bashkim

Shteti i Kosovës është i pavarur dhe sovran. Ai është mundësia dhe mjete për krijimin e shtetit të bashkuar të shqiptarëve. Integritet kombëtar në çdo fushë duhet të çojnë te bashkimi politik shtetëror. Kushtetuta e Kosovës do të **shprehë vullnetin dhe planin autentik të popullit shqiptar për bashkim kombëtar**. Ne angazhohemi për përkufizimin kushtetues të Kosovës si shtet i shqiptarëve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës. Ne angazhohemi për kthimin e dinjitetit, të domethënies dhe funksioneve të simboleve kombëtare shqiptare për shtetin e Kosovës dhe lidhjes emocionale e të mbështetjes nga qytetarët që i sigurojnë ato.

Ajo çka është pasuri kombëtare do t'u takojë pjesëtarëve të kombit. Do të sigurojmë që pasurinë e trashëguar, duke qenë se është edhe e drejtë e detyrë, t'ua lëmë në trashëgim gjeneratave të ardhme.

Shteti kombëtar u garanton barazi dhe përfshirje pakicave kombëtare, dhe atyre shoqërore. Ai nuk diskriminon e as nuk përjashton. Ai është shtet laik, hapësirë e barabartë dhe e lirë ku të gjithë pa dallim e realizojnë mënyrën e tyre të të jetuarit.

## Kuvendi dhe transparenca

Ne do të angazhohemi për avancimin e bazës ligjore, që e detyron kabinetin qeveritar t'i përgjigjet Kuvendit, duke paraparë edhe sanksionet e arsyeshme në rastet kur nuk ndodh një gjë e tillë. VETËVENDOSJE!-a do të rrisë **transparencën dhe pjesëmarrjen në vendimmarrjet e legjislativit**.

VETËVENDOSJE! do të kërkojë **shpeshkrimin e seancave plenare dhe të mbledhjeve të komisioneve parlamentare** me qëllim që të evitohen shtyrjet e miratimit të ligjeve, por edhe t'u jepet kohë dhe hapësirë e mjaftueshme dhe e domosdoshme trajtimit të ligjeve. Në Kuvendin e Kosovës, **puna e deputetit duhet të jetë punë me orar të plotë**.

**Transparenca** është parim ynë themelor. Të gjitha të dhënat publike duhet të jenë në dispozicion të publikut. VETËVENDOSJE do t'i **publikojë të gjitha pagat e zyrtarëve publik** që paguhen nga buxheti i shtetit. Në asnjë sektor publik apo qeveritar **nuk do të ketë pagë që shkon mbi trefishin e pagës mesatare** në Kosovë.

**VETËVENDOSJE!** garanton **liritë demokratike të qytetarit aktiv**, lirinë për të protestuar dhe lirinë për t'u organizuar e për t'u angazhuar politikisht. Liritë e patjetërsueshme qytetare mbrohen me një ligj që vlen njësoj për të gjithë qytetarët. Diskriminimi luftohet në po të njëjtën mënyrë. Asnjë qytetar e asnjë komunitet nuk bën të lirohet nga obligimi për të respektuar ligjin e për të paguar taksat.

## Gjyqësori

Gjyqësia e **fortë, efikase dhe e pavarur** është shtyllë e ndërtimit të demokracisë së mirëfilltë dhe njëkohësisht është forcë pozitive për zhvillim ekonomik dhe social, duke përfshirë edhe rritjen e besimit të investitorëve të huaj. Në një sistem të tillë mbrohen viktimat, dënohen fajtorët dhe kontestet zgjidhen me kohë, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

VETËVENDOSJE! është për funksionalizimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe themelimin dhe **fuqizimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës**, si bartës kryesor të gjyqësorit në Kosovë. Do të ndërtohet një **sistem efikas i mbrojtjes së dëshmitarëve**. Do të rritet qasja e publikut në gjykata përmes edukimit të qytetarëve për të drejtat e tyre si dhe për shërbimet që ofrohen në gjykatë.

VETËVENDOSJE! është për rishikimin e strukturës së pagesës së gjykatësve, prokurorëve dhe policëve, si dhe të përkrahjes institucionale më të gjerë, që është e nevojshme për institucionalizimin e një sistemi efektiv të së drejtës. Do të aprovohen ndryshime dhe plotësime të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës për arritjen e rezultateve më të mira në luftimin e kriminalitetit.

## Bashkimi i Mitrovicës

Bashkimi i Mitrovicës dhe integrimi i veriut në përgjithësi bëhet nëpërmjet një plani gjithëpërfshirës i cili do të përbëhet nga disa hapa të **bashkënduar politik, të sigurisë e socio-ekonomik**. Bisedimet me Serbinë pa kushte për të dhe për çështje të brendshme të Kosovës **do të ndërpriten**. Mallrave të Serbisë nuk do t'i lejohet hyrja në tregun e territorin tonë përderisa ajo nuk na e njeh pavarësinë, nuk kërkon falje e s'na i paguan dëmet e luftës.

Në veri të ketë një prezencë të shtuar të policisë për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme atje. Duhet të vihen në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme pa reciprocitet e simetri të të drejtave të serbëve në Kosovë me shqiptarët në Serbi. Jo para e privilegje, por zhvillim arsimor e ekonomik dhe barazi para ligjit. Jo bisedime me Serbinë e strukturat e saj, por integritet territorial për vendin e sovranitet për shtetin.

Rivalizimi i Trepçës, funksionalizimi i saj që do të rezultonte me punësimin e rreth 8.000 vetave. Do të ofrohen bursa për shqiptarët dhe serbët nga veriu për në shkollat e mesme dhe UP. Duhet të ketë investime në spitalin e Prishtinës dhe atë të Mitrovicës në mënyrë që atë të ofrohen shërbime më të mira.

Secili shqiptar i dëbuar duhet të ketë të drejtën të kthehet në pronën e vet në veri. Nuk do të lejohet më që Qeveria e Serbisë t'i blejë pronat e shqiptarëve në veri. Të gjithë shqiptarët që janë detyruar t'i shesin pronat e tyre, Qeveria e Kosovës do t'ua blejë ato.

## Të paditet Serbia

Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk e pranon shtetin e Serbisë. Dihet që Serbia nuk e pranon pavarësinë e Kosovës, nuk po e ndryshon kushtetutën e saj ku shkruan që Kosova është pjesë e Serbisë dhe nuk i ka kërkuar falje Kosovës për krimet ndaj popullit të Kosovës përgjatë gjithë shekullit XX.

Marrëveshjet e Qeverisë së Kosovës me Serbinë janë të papërfillshme për neve.

Do të përgatitet dokumentacioni me dëshmitë dhe faktet për krimet e Serbisë në Kosovë dhe do të hartohen paditë nga shteti, si dhe nga organizmat e tjerë bashkëpunues me Kosovën për krimet e Serbisë. Këto padi do të jenë të drejtuara në Gjykatat Ndërkombëtare.

## Lufta kundër korrupsionit

Zhvillimi shoqëror e ekonomik e përjashton korrupsionin, si dhe anasjelltas: korrupsioni e pamundëson zhvillimin. Po ashtu, nuk mund të ketë luftim të korrupsionit gjersa privatizimi është prioritet që zbatohet në emër të eliminimit të korrupsionit.

Ne konsiderojmë që krimet kundër qytetarëve të Kosovës nuk vjetrohen kurrë. Të gjithë ata që kanë uzurpuar, vjedhur, keqmenaxhuar me vetëdije pronën dhe parane publike, dhe prej të cilës kanë përfituar vetë, të përgjigjen para drejtësisë dhe qytetarëve. Por dënimi i kriminelit kurrë nuk është i mjaftueshëm pa e zbuluar e dënuar edhe origjinën e krimit. Në këtë drejtim ne angazhohemi që **popullit të Kosovës t'i kthehet e tërë pasuria e zhvatur në mënyrë të paligjshme** nga të gjithë personat për të cilët drejtësia do të dëshmonte që e kanë bërë një gjë të tillë, përmes konfiskimit të tërë pasurisë së paligjshme, duke trajtuar e hetuar rastet në mënyrë retroaktive dhe jo vetëm tash e tutje.

VETËVENDOSJE! do ta kërkojë aprovimin e **Ligjit për konfiskim të pasurisë së paligjshme** dhe aplikimin e tij, pa kufizime për kohën, vendin dhe mënyrën e përfitimit të paligjshëm. VETËVENDOSJE! do të kërkojë aprovimin e **Ligjit antimafia**, që garanton mjetet e duhura dhe mekanizmat hetues e kundërveprues ndaj krimit të organizuar dhe lidhjeve të tij me pushtetin. VETËVENDOSJE! do të kërkojë aprovimin e **Ligjit antikorrupsion**, që krijon mekanizmat për hetimin e cilitdo procesi të prokurimit, dhe të zyrtarëve të administratës;

Duke marrë parasysh rolin kyç që e kanë institucionet policore dhe gjyqësore në luftimin e korrupsionit në Kosovë, VETËVENDOSJE! do ta ketë prioritet sigurimin e kushteve adekuate të punës së prokurorëve dhe të punonjësve në agjenci të antikorrupsionit, si dhe të personave kyç që janë pjesë aktive e luftimit të kësaj dukurie.



## SOT

- Ligjet e Jugosllavisë
- Ligjet e Serbisë
- Ligjet e UNMIK-ut
- Ligjet e Ahtisaarit

## NESËR

- Kushtetuta e Re
- Ligjet e Republikës së Kosovës



## Rishikimi i kontratave të dëmshme

Lëvizja VETËVENDOSJE! e respekton pronën private dhe biznesin privat, por privatizimi i cili është bërë deri tash në Kosovë ka qenë privatizim për hir të vetvetes: **ne jemi kundër privatizimit si parim ideologjik**. Ne jemi kundër privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe pasurive strategjike të Kosovës

**Jemi kundër privatizimit** para se të bëhet dekolonizimi nga Serbia, para se të marrim nën kontroll dhe fusin në përdorim fondin aktual të privatizimit, para se të kemi planin afatgjatë të zhvillimit ekonomik, para se të kemi shtetin e fortë dhe të qëndrueshëm i cili do ta ketë kapacitetin për t'i kushtëzuar operatorët e pavarur ekonomik dhe para se të kemi ngritur infrastrukturën ligjore përmes së cilës eliminohet monopoli privat.

Ne angazhohemi që ta kemi një **vlerësim gjithëpërfshirës të procesit të deritashëm të privatizimit**. Secili proces privatizimi që gjykohet i dëmshëm për popullin e për shtetin, **do të rishqyrtohet, për të gjetur mundësitë e përfundimit të kontratave**, duke e ballafaquar këtë mundësi me koston që ajo ka. Secili proces privatizimi që rezulton në gjykatë si i parregullt, me shkelje ligjore si rezultat i korrupsionit apo i mosrespektimit të kontratës e të legjislacionit, **do të zhbëhet**.





## 2. Politikat e mbrojtjes, siguria dhe rendi

### Ushtria

Formimi i ushtrisë së Republikës së Kosovës përcakton zgjidhjen strategjike për sigurinë dhe stabilitetin e vendit në përputhje me nevojat dhe objektivat që duhet arritur në shkallë vendi.

VETËVENDOSJE! në programin e vet kombëtar për Ushtrinë e Republikës së Kosovës është e përcaktuar në ngritjen e një ushtrie moderne sipas standardeve euroatlantike, duke u bazuar në situatën dhe zhvillimin e proceseve, në ruajtjen e stabilitetit të brendshëm dhe rajonal, zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta me Republikën e Shqipërisë, dhe shtetet tjera anëtare të NATO-s.

**FSK duhet të shpallet dhe të bëhet ushtri e Kosovës.** Detyra e saj themelore kushtetuese do të jetë mbrojtja e pavarësisë dhe tërësisë territoriale, në përputhje me nevojat konkrete të vendit dhe standardet e strukturave euroatlantike të mbrojtjes së popullatës. Ushtria ka për detyrë kushtetuese dhe ligjore, që në raste të katastrofave,

qofshin ato të shkaktuara nga natyra apo nga faktori njeri, të mbrojtë jetët dhe pasurinë e tyre. Në detyrat e veta të përshkruara në ligj dhe në bazë të kushtetutës, Ushtria ka detyrime që së bashku me segmentet e tjera të sigurisë të mbrojtë dhe t'i ndihmojë autoritetet civile në mbrojtjen dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë në raste të jashtëzakonshme. Në përputhje me parimet republikane, ushtria do të mund të përdoret për situata të brendshme vetëm në rastet kur rrezikohet republika dhe popullata e saj.

**Shërbimi ushtarak do të jetë i detyrueshëm.** Shërbimi ushtarak parashihet sipas standardeve të BE-së dhe NATO-s. Duke u bazuar në rrethanat dhe situatën në rajon, shërbimi ushtarak për këtë fazë duhet të jetë i detyrueshëm me ligj. Ushtria e Kosovës ka nevojë për afër **20.000 trupa të armatosura.** VETËVENDOSJE! parashihet nevojën e një bashkëpunimi të ngushtë me aleancën e NATO-s për nevojat e veçanta të armatimit të Ushtrisë së Kosovës.

Është nevojë imediate **bashkëpunimi dhe bashkërendimi i detyrave të ushtrisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Republikës së Shqipërisë** për ta mbrojtur shtetin nga faktorët që mund ta rrezikojnë stabilitetin dhe cenojnë hapësirën territoriale kombëtare. Një bashkëpunim i dyanshëm është i domosdoshëm edhe për rajonin, për ta kthyer kombin shqiptar në faktor paqeje dhe stabiliteti.

Politikat e mbrojtjes të Kosovës dhe Shqipërisë duhet të përafrohen gradualisht, si në aspektin e legjisllacionit, ashtu edhe në atë të administrimit institucional. Kosova do të jetë e hapur për praninë e ushtrisë së Shqipërisë, ndërtimin e përbashkët të bazave, shkollave, qendrave stërvitore etj., në territorin e saj, krahas bazave ushtarake të NATO-s; njëkohësisht do të punojë me qeverinë e Shqipërisë për t'u mundësuar qytetarëve të Kosovës ta kryejnë shërbimin, arsimimin dhe stërvitjen ushtarake pranë ushtrisë së Shqipërisë dhe anasjelltas;

VETËVENDOSJE! parashihet një **bashkëpunim të ngushtë me strukturat e NATO-s** dhe segmentet tjera veriatlantike të sigurisë,

gjithnjë në funksion të një stabiliteti rajonal. VETËVENDOSJE! konsideron se pjesëmarrja me forcat e sigurisë dhe bashkëpunimi bilateral i forcave të Kosovës dhe atyre të BE-së dhe të NATO-s, siguron ngritjen e misioneve paqeruajtëse rajonale dhe ndërkombëtare, por vetëm dhe domosdoshmërisht në transparencë të plotë ndaj shoqërisë dhe institucioneve tona, dhe në përputhje me ligjet e vendit tonë, e me frymën e respektimit të së drejtës së popujve për liri e për vetëvendosje.

## Policia

Policia zbaton ligjin, mbron njerëzit dhe pronën, ruan rendin dhe qetësinë. Policia konceptohet si një institucion në funksion në shërbim të qytetarit dhe të ligjit, e jo në shërbim të pushtetit. Policia duhet të garantojë zbatimin e ligjit dhe ruajtjen e garantimin e të gjitha të drejtave qytetare, njerëzore e politike të popullit, përfshirë këtu edhe të drejtën demokratike për protestë e për organizim politik.

Do të themelohet **Akademia Policore**, me cikël shkollimi 3 vjeçar (bachelor) për hyrje në shërbimin policor, me qëllim të rritjes së profesionalizmit në polici.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për **kushte më të mira** të punës për policët dhe zhdëmtim adekuat në rast të lëndimeve ose humbjes së jetës në detyrë.

VETËVENDOSJE! synon një bashkëpunim sa më të ngushtë me Policinë e Shqipërisë dhe aplikim të standardeve dhe praktikave më të mira të BE-së. Ky bashkëpunim institucional midis dy ministrive të brendshme do të bëjë të mundur luftën ndaj krimit në hapësirat shqiptare, e njëkohësisht do të garantojë mirëqenien dhe qetësinë shoqërore.





## 3. Politika e jashtme dhe reciprociteti

Lëvizja VETËVENDOSJE! politikën e jashtme e shih të lidhur ngushtë me politikën e brendshme dhe si zgjerim të saj. **Politika e jashtme e Kosovës duhet t'i mbrojtë interesat e Kosovës, të shtetit dhe të qytetarëve, si dhe interesat kombëtare të shqiptarëve.** Në këtë drejtim **ne zotohemi që ta kemi NJË politikë të jashtme me Shqipërinë** dhe të veprojmë bashkërisht për qëllimet e përbashkëta të kombit, duke e ndikuar dhe plotësuar njëra-tjetrën, e jo duke garuar me njëra-tjetrën.

Marrëdhëniet me shtetet tjera duhet të bazohen në dy parime bazë, njohja dhe respektimi i ndërsjellë i lirisë dhe vetëvendosjes, dhe interesi reciprok për bashkëpunim. Në këtë drejtim Kosova duhet të jetë e hapur të bashkëpunojë me secilin shtet. Është e domosdoshme që shtetet shqiptare dhe shtetet ku banojnë shqiptarët, dhe ku ata gëzojnë përfaqësim, të bashkëpunojnë duke i vënë në funksion institucionet formale për të forcuar pozitën e kombit tonë në Ballkan.

Lëvizja VETËVENDOSJE! **raportet bilaterale i konsideron më të rëndësishme** për shtetin se ato multilaterale. Jo se kjo e fundit duhet neglizhuar por pse pikërisht e para është neglizhuar. Secila marrëveshje, qoftë bilaterale apo multilaterale, e cila nuk na njeh subjektivitetin shtetëror është e papranueshme për ne. Nga parimi i sovranitetit dhe nga parimi i barazisë ndërmjet shteteve e të reciprocitetit, do të rishikohen dhe ndryshohen të gjitha marrëdhëniet asimetrike me shtetet e tjera. **Republika e Kosovës nuk e pranon Republikën e Serbisë.** Kjo do të ndodh për sa kohë Serbia nuk na njeh dhe nuk ndryshon karshi Kosovës.

Në politikën e jashtme, marrëdhëniet e Kosovës me shtetet e tjera do të **varen nga qëndrimi i këtyre të fundit ndaj pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës,** ndaj shqiptarëve dhe çështjes shqiptare në përgjithësi. Në politikën e jashtme është i domosdoshëm dallimi i shteteve mike dhe atyre jo-mike varësisht nga politikat e qëndrimet e tyre shtetërore. Sikurse çdo shtet normal, edhe Lëvizja VETËVENDOSJE! marrëdhëniet tregtare i sheh nga prizmi i politikës së jashtme, pra e vlerëson edhe nga ana gjeostrategjike bashkëpunimin me shtetin tjetër. **Nuk mund të ketë marrëveshje të tregtisë së lirë me shtetet që nuk na njohin,** përveç me BE-në.

Me shtetet që e kanë njohur Kosovën Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që t'i thellojë raportet bilaterale në tërheqjen e investimeve, programet e shkëmbimit, asistencë teknike për ngritjen e kapaciteteve dhe ndihma për arritjen e njohjeve të reja. Ne e shohim si të pashmangshëm kontributin e mërgatës së Kosovës për thellimin e këtyre raporteve

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të vendosë **raporte të mira me pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën.** Ne do të angazhohemi që gradualisht të ndërtojmë raporte të mira formale me këto vende. Këto shtete aktualisht nuk e njohin Kosovën formalisht, por me këto vende duhet medoemos që të kemi raporte zyrtare, në mënyrë që të ndërtojmë marrëdhënie bashkëpunimi me interes reciprok dhe të mos pengohet integrimi i Kosovës në BE dhe NATO. Me pushtetin e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Qeveria



e Kosovës do të ketë bashkëpunime më të ngushta me shtetet që kanë mërgatën më të madhe shqiptare, si SHBA, Gjermania, Britania e Madhe, Zvicra, Italia, Turqia etj.

Parimet e njëjta të bashkëpunimit (njohja e ndërsjellë dhe interesi reciprok) vlejnë edhe për vendet e rajonit. **Ne nuk pranojmë asnjë lloj marrëveshje të bërë në emër të Kosovës pa pëlqimin e Kosovës** për çfarëdo rregullimi territorial apo të kufijve të Kosovës, apo marrëveshje të tregtisë të arritura për Kosovën në kohën kur Kosova ishte e okupuar nga Serbia. Këto marrëveshje do t'i shpallim të pavlefshme menjëherë.

**Politika e jashtme e Kosovës në rajon duhet të përqendrohet në marrëdhëniet me shqiptarët** të cilët jetojnë nëpër vendet që na rrethojnë, pra politika e jashtme të përpilohet varësisht nga pozita dhe gjendja e shqiptarëve në ato vende. Një aspekt i veçantë i kësaj politike është kontakti i rregullt, i shpeshtë dhe i drejtpërdrejtë me shqiptarët jashtë kufijve të Kosovës dhe Shqipërisë.

**UNMIK-u është i papranueshëm** dhe me qeverinë e VETËVENDOSJE!-s Rezoluta 1244 (1999) do të shpallet e pazbatueshme dhe do t'i dërgohet letër SP të OKB-së; Në vend të UNMIK-ut ne mirëpresim një përfaqësues të OKB-së si zyrë koordinuese për mekanizmat e tjerë të OKB-së: UNDP, UNHCR, UNFPA, UNWTO etj.

Ne do të fillojmë negociata me **NATO-n për një SOFA marrëveshje të re të qëndrimit të tyre në Kosovë**, ndryshe prej Marrëveshjes së Kumanovës që u arrit me gjeneralët serbë të Jugosllavisë së Milosheviqit; Po ashtu do të nisim edhe negociata me BE-në për transformimin e pranisë së tyre në përputhje me parimet kushtetuese dhe ridefinimin e paradigmës së tyre në Kosovë: nga sundimi bazuar në doktrinën e stabilitetit dhe menaxhimit të krizës te ndihma për zhvillim të qëndrueshëm dhe demokraci;

**Ne jemi për aderimin e Kosovës në organizatat mbikombëtare (NATO, BE, etj.).** Mirëpo insistojmë që kjo të bëhet përmes një rruge normale të ndjekur nga të gjitha shtetet tjera deri tash. Edhe këtu vlejnë parimet e njohjes së ndërsjellë dhe reciprocitetit të interesit. Ne duhet ta kemi të drejtën për të aderuar në organizma ndërkombëtarë e jo vetëm të merremi në pyetje nëse jemi për këtë apo atë integrim. Prania e organizatave ndërkombëtare, ushtarake e civile në Kosovë, dhe e Kosovës në to, është e mirëpritur dhe objektiv qeverisës, për aq sa ato të jenë në përputhje me parimet kushtetuese tona e do të përfaqësohen nga shtetas të shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës;

## Njohja dhe shërbimi diplomatik

Lëvizja VETËVENDOSJE! beson që jo vetëm zyrtarët shtetërorë ndikojnë në avancimin e Kosovës në skenën ndërkombëtare. Këtë avancim mund ta bëjnë sektorët jopublikë si komunitetet e sportistëve, artistëve dhe ai i biznesit. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për një përfaqësim të gjerë të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Kësisoj, ne besojmë se një shtrirje më e gjerë e shërbimit diplomatik të Kosovës, do të ndikojë në avancimin e vendit në sferën ndërkombëtare, pa e rritur koston e këtij shërbimi. Ne angazhohemi për ngritjen e kapaciteteve të diplomacisë, duke e koordinuar atë si në planin politik ashtu edhe në realizimin teknik me shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

Urgjentisht duhet të konsolidohet shërbimi diplomatik i Kosovës. Së fundmi, ka pasur ndryshime në shërbimin diplomatik, më saktësisht, në mënyrë krejtësisht të paligjshme janë emëruar ambasadorë që do të zëvendësojnë ata që nuk e kanë mbaruar mandatin ende. Me cenim të njërit nga parimet themelore të shërbimit diplomatik (i parashikueshmërisë dhe kontinuitetit) është degraduar dhe infektuar partiakisht një shërbim i cili do të duhej të jetë profesional, në shërbim të vendit dhe jo të një partie sot e të një partie tjetër nesër. Pra, departizimi i shërbimit diplomatik është i domosdoshëm nëse duam të kemi profesionalizëm dhe të nxjerrim sa më shumë efikasitet në arritjen e objektivave të punëve të jashtme.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për njohje të Kosovës nga shtetet sovrane. Këtë, ne do ta arrijmë përmes ndryshimit të qasjes aktuale rreth lobimeve për njohje, duke vënë në funksion shërbimin diplomatik, angazhimin ndërinstitucional, përkrahjen e shteteve mike, si dhe lobimin formal e joformal.

Lëvizja VETËVENDOSJE! beson se mërgata mbetet një ndër asetet më të mëdha të Kosovës. Ne angazhohemi që ta afrojmë mërgatën me Kosovën, përmes një shërbimi efikas konsullor të shtrirë mirë nëpër vendet e banuara me shtetas të Kosovës.

Ne e njohim rëndësinë e paqes botërore. Paqja nuk mund të arrihet në kushtet e shtypjes së popujve më të vegjël nga shtete më të fuqishme. Lëvizja VETËVENDOSJE! njeh dhe vlerëson luftën e drejtë çlirimtare të popujve të robëruar për çlirim dhe vetëvendosje. Ne konsiderojmë se paqja botërore mund të arrihet vetëm në bazë të parimeve universale të drejtësisë, vetëvendosjes dhe barazisë. Ne fuqimisht kundërshtojmë secilën tendencë kolonizuese, shfrytëzuese, përndjekëse, ndaj popujve të vegjël, tendenca këto të cilat veprojnë në kundërshtim me të drejtën dhe interesin e secilit popull për liri dhe zhvillim.





## 4. Pushteti lokal

Lëvizja VETËVENDOSJE! e mbështet **afrimin e pushtetit me qytetarin**, dhe decentralizimin e pushtetit në linja administrative dhe socio-ekonomike, por është **kundër decentralizimit etnik**. Decentralizimi qytetar dhe ekonomik prodhon pjesëmarrje, komunitet, zhvillim dhe demokraci. Decentralizimi etnik prodhon ndarje dhe diskriminim etnik, si dhe mundëson angazhimin e forcimin e strukturave ilegale të Serbisë në Kosovë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për një administratë lokale të fuqishme, e cila do t'iu ofrojë të gjithë qytetarëve shërbime efikase aty ku ata banojnë.


Ne angazhohemi për **planifikim afatmesëm dhe afatgjatë të komunave**, në koordinim me njëra-tjetrën dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve e të ekspertëve, gjë që ende nuk ka ndodhur. Edhe sot shumica e tyre nuk kanë plan zhvillimor. Poashtu angazhohemi për përmirësimin e politikave të **ndarjes së granteve qeveritare për komonat, duke u bazuar në numrin e banorëve** dhe në prioritetet për zhvillim ekonomik, e jo në bazë të strukturave e preferencave politike siç ka ndodhur deri tash;

Lëvizja VETËVENDOSJE! zotohet për **rritje të transparencës dhe përfshirjes në vendimmarrje**, duke zgjeruar hapësirën ligjore dhe praktikën komunale për përfshirje efikase të grupeve të shoqërisë civile në proceset konsultative për vendimmarrjet e rëndësishme komunale. VETËVENDOSJE! angazhohet për zhvillimin e politikave proaktive që garantojnë shpërndarje proporcionale dhe të drejtë të taksave të mbledhura nga qytetarët;

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që në Ligjin e ri për Vetëqeverisje Lokale t'i **forcojë më shumë kompetencat e kuvendit komunal** dhe të ekzistojë një ndarje më e qartë e pushteteve. Kjo ndarje duhet ta përfshijë edhe komunën e Prishtinës;

Lëvizja VETËVENDOSJE! do të angazhohet për ndërtimin e objekteve të administratave komunale, me qëllim që shërbyesit civilë në komuna ta kryejnë punën e tyre si duhet dhe të përmirësohet kontakti me qytetarë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! vlerëson se **këshillat lokale, si organe joformale, ndihmojnë dhe këshillojnë të gjithë shtetasit**, sidomos ato në viset rurale, për qasje në shërbimet publike. Andaj fuqizimi i këtyre këshillave do të ndihmojë shumë në procesin e vendimmarrjes dhe bashkëfinancimet në projektet për komunitetin si dhe organizimin socio-kulturor të qytetarëve



## 5. Pakicat kombëtare

Lëvizja VETËVENDOSJE! i konsideron **pakicat kombëtare si vlerë dhe pasuri të Republikës së Kosovës**. Ne angazhohemi për **mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve** të Kosovës që lirisht identifikohen si pjesëtarë të një pakice kombëtare që jeton në Kosovë.

Ne konsiderojmë se çdo person që i takon një pakice kombëtare është i barabartë para ligjit dhe gëzon mbrojtje të barabartë të ligjit. Ne besojmë se çelësi për krijimin e barazisë qëndron tek **qasja në shkollim dhe punësim**, dhe për rrjedhim, mendojmë që pikërisht në këto fusha duhet të nisë integrimi. Lëvizja VETËVENDOSJE! beson fuqimisht se mënyra më efektive për të garantuar mbrojtjen e pakicave është ndërtimi i një shteti funksional të së drejtës dhe një shteti zhvillimor që ofron drejtësi, mundësi ekonomike dhe mirëqenie për gjithë popullin e Kosovës.

Lëvizja VETËVENDOSJE! mbron qëndrimin se të gjitha grupimet tashmë të përkufizuara si 'komunitete' ose 'komunitete joshumicë', duhet të **përkrahin ligjërisht dhe me Kushtetutë si 'pakica kombëtare'**, që është term i përdorur në konventat ndërkombëtare.

Të drejtat e pakicave në Kosovë janë definuar në planin final të Ahtisaarit, i cili duke pranuar disa kërkesa të Beogradit, ndërtoi një sistem të privilegjeve ekskluzive të vetëqeverisjes territoriale dhe institucionale në bazë etnike dhe fetare, që i takojnë vetëm pakicës serbe në Kosovë dhe imponoi një identitet 'multi-etnik' në nivel shtetëror. Plani i Ahtisaarit ndërtoi një strukturë hierarkike dhe të padrejtë, sipas së cilës njëra prej pakicave – ajo serbe – është e privilegjuar ndaj pakicave të tjera. Rezultati është krijimi i tri (3) kategorive të qytetarëve (shumicë, pakicë serbe dhe pakica të tjera) me të drejta të pabarabarta për etnitetet. Në këtë strukturë, pakicat joserbe në Kosovë ndihen me të drejtë të diskriminuara.

Ne besojmë që është e drejtë edhe demokratike që Kosovën **ta përkufizojmë si një vend ku shumica ka identitet shqiptar**. Natyrisht, kjo shprehje demokratike e identitetit të shumicës në asnjë moment **nuk nënkupton asimilimin e pakicave** dhe nuk bie në kundërshtim me respektimin e së drejtës së pakicave dhe vlerës së tyre si pakica historike të Republikës së Kosovës.

Ne propozojmë që në nivel komunal **gjuha zyrtare të aplikohet për pakicat që përbëjnë të paktën 5% të popullatës**, ose nëse komuna vendos, edhe atëherë kur përqindja është më e vogël. Në nivel shtetëror, ne propozojmë që vetëm gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare sepse flitet nga mbi 92% e popullatës, ndërkohë që gjuha angleze të jetë pjesë e programit të detyrueshëm mësimor, sepse është një gjuhë që i bashkon të gjitha pakicat në vend dhe është gjuhë globale e tregtisë, teknologjisë dhe politikës. Gjithashtu, ne do të angazhohemi që shkollat të ofrojnë kurse joobligative të gjuhës shqipe për nxënësit e pakicave dhe kurse të gjuhës së pakicave për nxënësit shqiptarë.

Sipas konventave ndërkombëtare shteti duhet t'iu garantojë pakicave të drejtën e shprehjes, mbrojtjen dhe kultivimin e identitetit të tyre nacional, dhe përdorimin e lirë të simboleve të tyre kombëtare, të drejtën e shprehjes së fesë ose besimit të tyre dhe të drejtën për të themeluar organizata dhe institucione fetare, përdorimin e gjuhës së tyre në institucione dhe në administratën publike, dhe në institucionet gjyqësore dhe policore, shkollimin me tekste dhe kurrikulum të Republikës së Kosovës në gjuhët e tyre përkatëse, duke përfshirë



mësimet që adresojnë historinë dhe kulturën e tyre dhe të shumicës, themelimin, mbajtjen dhe zhvillimin e medimeve të tyre në gjuhët e tyre përkatëse, afirmimin e mirëqenies sociale të pakicave si dhe garantimin e mundësive të barabarta për punësim.

Ne përkushtohemi të mbrojmë pakicat kombëtare me ligje pozitive ndaj çfarëdolloj diskriminimi dhe me politika të veçanta, duke përfshirë edhe masat afirmative. Ne angazhohemi që të eliminojmë çfarëdo manifestimi të diskriminimit institucional në Kosovë ndaj personave që i përkasin një pakice kombëtare. Do ta bëjmë prioritet zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit nga institucionet e drejtësisë dhe në institucionet publike dhe private.

Ne mendojmë se koncepti i vendeve të rezervuara në Kuvendin e Kosovës është në **kundërshtim me parimin e barazisë së qytetarëve para ligjit**. Për më tepër, vlerësojmë se mungesa e demokracisë në procesin e zgjedhjeve të kandidatëve të pakicave për vendet e rezervuara ka krijuar kushte vetëm për akomodimin e elitave politike të pakicave, të cilat ndonjëherë ndodh të shkëputen nga komunitetet e tyre.

Lëvizja VETEVENDOSJE! e njeh dhe do ta sigurojë të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtar për të qenë të përfaqësuar në institucionet publike nga subjektet e veta. Në vend të një sistemi me vende të rezervuara, Lëvizja VETEVENDOSJE! propozon një sistem alternativ që garanton të drejtën e përfaqësimit të pakicave në institucionet politike të Kosovës mbi parimin e një pragu zgjedhor që caktohet sipas përqindjes së popullatës së pakicës kombëtare. Kështu demokratizohen zgjedhjet e përfaqësuesve politikë të pakicave. Për shkak të dallimit të madh ndërmjet përqindjes së serbëve në Kosovë dhe të pakicave të tjera, të cilët përbëjnë veçmas më pak se 2% ose 1% të popullatës, do të shqyrtojmë përdorimin e dy pragjeve sekondare për pakicat për të siguruar të drejtat e përfaqësimit të tyre.

Lëvizja VETEVENDOSJE! nuk i sheh mekanizmat e shumicës së dyfishtë sipas Pakos së Ahtisarit si të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Ne i konsiderojmë këta dy mekanizma si jodemokratik, sepse e ndryshojnë peshën e votave të qytetarëve në

Kuvendin e Kosovës dhe sepse ekzistojnë më shumë për t'i bërë të obligueshme pikat e Planit të Ahtisaarit.

Kualifikimi i minoriteteve **ashkali, egjiptian dhe rome në një akronim të përbashkët është kualifikim racist**. Në këtë akronim kriter për bashkimin e këtyre minoriteteve është përdorur ngjyra e lëkurës. Është e papranueshme që në Republikën e Kosovës të krijohen kategori politike mbi baza racore. Komunitetet e ashkalinjeve, egjiptianëve dhe romëve janë bashkësi të cilat ndodhen në gjendjen më të mjerueshme në Republikën e Kosovës. Ata e përjetojnë një diskriminim të dyfishtë: sepse përbëjnë të diskriminuarit brenda të diskriminuarve.

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për miratimin e një **ligji të veçantë për mbrojtjen e pakicave ashkali, egjiptian dhe rome** në Kosovë dhe garantimin e mbështetjes së mjaftueshme politike dhe financiare për zbatimin dhe mbikëqyrjen e strategjisë ekzistuese kombëtare për pakicat rome, ashkali dhe egjiptiane. VETËVENDOSJE! do të mirëpresë **mbikëqyrjen ndërkombëtare nga institucionet me ekspertizë në këtë fushë të përpjekjeve të Kosovës për të përmirësuar të drejtat dhe liritë e atyre që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian**. Ne do të kërkojmë aktivisht për të marrë pjesë në iniciativat ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje.

Ne do të respektojmë të **drejtën e çdo person për t'u kthyer në shtëpinë e vet** dhe do të mirëpresim dhe do të asistojmë rikthimin e të gjithë personave të zhvendosur, me përjashtim të atyre që mbajnë përgjegjësi për krimet e kryera gjatë luftës. Ne nuk do të detyrojmë fshatrat që të pranojnë të kthyerit kundër vullnetit të tyre, nëse ende kanë numra të konsiderueshëm personash të pagjetur nga komuniteti i tyre, dhe nëse nuk kanë marrë ende asnjë informacion, apo drejtësi për pasojat e luftës.

## Reciprociteti

Respekti reciprok për të drejtat, liritë dhe obligimet e pakicave kombëtare në të gjitha vendet e Ballkanit mund të bëhet më i qëndrueshëm nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve bilaterale që **garantojnë mbrojtjen reciproke** për pakicat përkatëse.

Ne do të mbështesim plotësisht Zyrën e Avokatit të Popullit për **monitorimin dhe mbikëqyrjen e pavarur të respektimit dhe zbatimit të lirive dhe të drejtave të pakicave në Kosovë**, me vëmendje të veçantë sidomos në çështjet e pjesëmarrjes së barabartë në edukim, në përdorim të gjuhës amtare dhe në punësim.

Ne do të ndryshojmë emrin e Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve duke reflektuar në këtë mënyre përgjegjësitë e ministrisë në planifikimin dhe zbatimin e të gjitha politikave për pakicat kombëtare. Emri i ri do të jetë Ministria e Çështjeve të Pakicave. Lëvizja VETËVENDOSJE! do të trajtojë pozitën e ministrit për çështje të pakicave si një pozitë të lartë të kabinetit.

Ne synojmë të krijojmë kushtet në Kosovë në të cilët pakicat kombëtare mund të gëzojnë të drejtat e tyre të lira nga pengesat e politikave të shteteve që kanë si qëllim minimin e sovranitetit të Kosovës. Duke gëzuar të drejtat e tyre në bazë të statusit të tyre si shtetas të Kosovës, dhe si qytetarë e tjerë, personat që i takojnë një pakice kombëtare nuk mund të punojnë kundër sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës.